



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 233/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Vera Gashi Bala, në çështjen përmbartimore të kreditorit B.B BI, me NUI, rr. “Nexhmedin Musliu”, fshati Shupkovc, Komuna Mitrovicë, kundër debitorit DT MINING Sh.P.K., me NUI 811287350, rr. “Marin Biqkemi”, p.n. Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit, të ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr.4/20, të datës 08.01.2020, i caktuar nga Përmbartuesi Privat, Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi i pa bazuar prapësimi i debitorit DT MINING Sh.P.K., me NUI 811287350, i ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr 4/20, i lejuar me datë 08.01.2020, nga Përmbartuesi Privat Eset Murati.
- II. Urdhri Përmbartimor P.nr 4/20, i lejuar me datë 08.01.2020, nga Përmbartuesi Privat Eset Murati, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit B.B BI, mbi bazën e dokumentit të besueshëm - Faturës nr. 01/2019, të datës 21.11.2019, ka caktuar përmbartimin me urdhrin P.nr. 4/20, të datës 08.01.2020, me të cilin është urdhëruar debitori që në afat prej 7 ditësh pas pranimit të këtij urdhri t’i paguaj kreditorit borxhin në lartësi prej 5,000.00 € me kamatë ligjore 8% nga dita e rënies në vonesë 21.12.2019 e deri në pagesën definitive dhe shpenzimet përmbartimore në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.06/2014 për tarifat për

shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për Përmbartesit Privat, nën kërcënim të përmbartimit të dhunshëm.

Debitori, brenda afatit ligjor ka ushtruar prapësim duke theksuar se ashtu siç është në dijeni edhe pronari i kompanisë z.B.B, në si kompani nuk kemi marr asnjëherë shërbime profesionale siç mund të dokumentohet dhe me emailin e dërguar me datën 06.01.2020 ku i sqarojmë se nuk kemi pranuar as një shërbim nga kompania B.B BI. Tutje thekson se me mirëbesim dhe bashkëpunim ka vulosur dhe nënshkruar faturën dhe marrëveshjen, por nuk kanë pranuar asnjë raport apo dokument i cili vërteton kryerjen e shërbimit të dakorduar. Tutje shton se konsideron se kreditori kundërligjshëm është duke pretenduar obligimin prej 5,000.00 euro. Andaj kërkon prapësimin e urdhrit përmbartimor.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke theksuar se fatura është pranuar nga debitori me datë 21.11.2019 dhe nga ana e debitorit nuk është bërë denoncimi i të njëjtës por qëllimi është zvarritja e pagesës. Tutje thekson se pasi që debitori nuk ka ofruar prova me të cilat do ti mbështeste pretendimet e tij i propozon gjykatës që në përputhje me nenin 73.3 të LPP-së ta refuzoj prapësimin e debitorit si të pabazuar, kurse urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar dhe vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, për këto arsye:

Sipas nenit 29, paragrafi 1 i LPP-së, *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa, pika 1.3 e të njëjtit nen përcakton faturën si dokument i besueshëm sipas të cilës mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla. Tutje, sipas paragrafit 3, të nenit 29 të LPP-së, *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, ndërsa, sipas nenit 37 të LPP-së: *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit”*.

Gjykata vlerëson se urdhri i caktuar nga ana e përmbartuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm – përkatësisht faturën nr. 01/2019, të datës 21.11.2019, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm siç kërkohet me nenin 29, paragrafi 3 të LPP-së, për arsye se në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë emërtuar mallrat me të cilat është shërbyer debitori, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Gjithashtu, fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri përmbartimor është pranuar me rregull nga ana e debitorit ngase e njëjta mban nënshkrimin e debitorit. Rrjedhimisht, debitori ka qenë i njoftuar me detyrimin nga kjo faturë.

Andaj, gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbartimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në kopje të vërtetuar si dhe mban vulën dhe nënshkrimin e debitorit.

Gjykata ka vlerësuar pretendimet e debitorit i cili ka theksuar se nuk kanë marr asnjëherë shërbime profesionale siç mund të dokumentohet dhe me emailin e dërguar me datën 06.01.2020, mirëpo gjeti se debitori nuk ka paraqitur ndonjë provë për të mbështetur një fakt të tillë, në kuptim të nenit 69, paragrafi 4 të LPP-së, me të cilin parashihet se: *“Baza për prapësim duhet të mbështetet me prova të duhura. Provat për prapësimin duhet të dorëzohen me shkrim, përndryshe prapësimi do të refuzohet”*, e as që ka njoftuar gjykatën se i njëjti ka iniciuar çfarëdo procedure ligjore për vërtetimin e faktit se fatura mbi bazën e të cilës është lejuar urdhri është e kundërligjshme. Emaili i dërguar nga debitori nuk konsiderohet denoncim i faturës pasi që i njëjti vetëm i referohet tërheqjes nga projekti.

Gjykata, rikujton se procedura përmbartimore i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 29 dhe 37 të LPP-së.

Në këtë drejtim, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore të përcaktuara në nenin 71 të LPP-së, mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbartimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73, paragrafi 3 të LPP-së, nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, dhe Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.233/22, datë 28.07.2023

Gjyqtarja

Vera Gashi Bala

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimet të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.